RAPORT

Mbi zbatimin e rekomandimeve sipas Rezolutës së Kuvendit 2020 për Institutin e Statistikave

I nderuar Z. Kryetar i Kuvendit,

Mbështetur në Vendimin e Kuvendit nr. 49/2017, datë 20.4.2017 "Për krijimin e mekanizmit për monitorimin sistematik të ndjekjes dhe zbatimit të rekomandimeve të institucioneve të pavarura kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj", lutemi gjeni në vijim informacionin mbi progresin e deritanishëm në zbatim të rekomandimeve të Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë "Për vlerësimin e veprimtarisë së Institutit të Statistikave për vitin 2020":

Rekomandimi 1

Të ketë transparencë të plotë të kontributit që jep Këshilli i Statistikave në INSTAT në përmbushje të detyrimeve që i ngarkon ligji nr 17/2018 "Për statistikat zyrtare". Të publikohen raportet e rekomandimeve të lëna nga Këshilli i Statistikave dhe aktet e miratuara nga Bordi Drejtues, duke respektuar kufizimet e legjislacionit të fushës për mbrojtjen e të dhënave konfidenciale. Të publikohet pjesëmarrja e anëtarëve në çdo mbledhje dhe mënyra se si ka votuar.

Statusi: Realizuar

Këshilli i Statistikave, në mbledhjen e tij të datës 05.11.2020 vendosi të publikojë të gjitha aktet e miratuara në faqen zyrtare të INSTAT, pjesëmarrjen e anëtarëve në mbledhje si dhe përmbledhësen e çështjeve të diskutuara në mbledhje sipas rendit të ditës.

Aktet e Bordit Drejtues janë publikuar në faqen zyrtare të INSTAT.

Rekomandimi 2

Të plotësojë sa më parë vendet vakante në pozicionet e nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues, për të garantuar menaxhimin e nëpunësve civilë sipas ligjit 152/2013 "Për nëpunësin civil".

Statusi: Realizuar pjesërisht

Njësia përgjegjëse e menaxhimit të burimeve njerëzore në INSTAT ka shpallur vendet vakante për pozicionin "Sekretari i Përgjithshëm" dhe "Drejtor në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve Mbështetëse dhe Koordinimit". Sekretari i Përgjithshëm është emëruar në muajin Dhjetor 2020, ndërkohë që për pozicionin e drejtorit të drejtorisë së përgjithshme nuk ka patur fitues. INSTAT do të rishpallë pozicionin vakant në fillim të vitit 2021.

Rekomandimi 3

Të marrë masa konkrete për të reduktuar riskun e veprimtarisë statistikore, që mund të shkaktohet nga rastet e fatkeqësive natyrore, në mënyrë që të sigurohet vazhdimësia e proceseve. Masat e marra të paraqiten në planin vjetor të INSTAT-it.

Statusi: Realizuar

Plani Vjetor 2021, i dërguar për miratim në Nëntor 2020 pranë Këshillit të Ministrave dhe Kuvendit, parashikon edhe masat për reduktimin e riskut në rast të fatkeqësive natyrore. Gjithashtu, aktivitetet zbatuese në këtë aspekt janë parashikuar edhe në Planin Operacional 2021 të INSTAT, miratuar nga Bordi Drejtues. Planet e vazhdimësisë sipas aktiviteteve statistikore në rastet e fatkeqësive natyrore janë pjesë e regjistrit të riskut dhe e këtij plani.

Rekomandimi 4

Të fuqizojë kapacitetet e teknologjisë së informacionit, si në infrastrukturë ashtu edhe në staf të kualifikuar për përpunim modern të dhënash dhe prodhim statistikash cilësore.

Statusi: Në proces

Për realizimin e këtij rekomandimi, janë parashikuar tre aktivitete:

1. Ndërtimi i sistemit të integruar "SIMONA", për të mundësuar akses në mikro të dhëna për kërkuesit shkencorë - **realizuar**

2. Kryerja e investimeve në fushën e TI - **në vazhdimësi**

3. Trajnim i stafit për ngritje kapacitetesh - **në vazhdimësi**

Rekomandimi 5

Të vazhdojë punën për përmirësimin e pyetësorit të Censit, si edhe materialeve të tjera shoqëruese, bazuar në gjetjet e Pilot Censit të kryer në vitin 2019, si dhe të përditësojë zonat në terren pas situatave të krijuara nga emergjencat e fundit që kanë ndodhur në vend.

Statusi: Në proces

Për arsye të gjetjeve të pilotit të censit, të kryer në periudhën tetor-nëntor 2019, INSTAT ka vijuar punën për përditësimin e ndërtesave në zonat e prekura nga tërmeti. Ky ushtrim do të vazhdojë edhe për vitin 2021. Një pilot i dytë është parashikuar të kryhet në tetor të vitit 2021, pas përfundimit të tij, do të arrihet në hartimin e pyetësorit përfundimtar të censit.

Sipas ligjit nr. 140/2020 "Për censin e popullsisë dhe banesave", pyetësori i censit së bashku me periudhën e propozuar të censit do t'i dërgohen për miratim Kuvendit të Shqipërisë brenda muajit Dhjetor 2021, nëpërmjet Planit Vjetor 2022 për zbatimin e Programit të Statistikave Zyrtare.

Rekomandimi 6

Të hartojë Strategjinë dhe Planin e Veprimit për Censin e Bujqësisë 2022.

Statusi: Në proces

Pas përpjekjeve dhe komunikimeve me donatorët, INSTAT ka arritur të gjejë burimin e financimit nëpërmjet FAO-s për asistencën teknike që do të angazhohet në përgatitjen e strategjisë së Censit të Bujqësisë. Për arsye të shtyrjes se censit të popullsisë dhe banesave nga viti 2020 në vitin 2022, për arsye edhe të metodologjisë, INSTAT propozon shtyrjen e Censit të Bujqësisë për vitin 2023.

Rekomandimi 7

Të harmonizojë Strategjinë e Zhvillimit të Sistemit Kombëtar Statistikor me formatin e strategjive të tjera kombëtare dhe sektoriale për Sistemin e Menaxhimit të Informacionit për Planifikimin e Integruar, IPSIS, përfshirë edhe hartimin e planit strategjik për përafrimin me acquis në fushën e statistikave, duke marrë në konsideratë edhe prioritetet e vendosura nga BE-ja në procesin e çeljes së negociatave me Shqipërinë.

Statusi: Realizuar pjesërisht

Strategjia e Zhvillimit te Sistemit Kombëtar Statistikor është përshtatur sipas strukturës së integruar IPSIS. Gjatë vitit 2021 INSTAT, në bashkëpunim me strukturën e menaxhimit të strategjive pranë Kryeministrisë do të propozojë rrugën për miratimin e dokumentit nga ana formale dhe do ta hedhë atë në sistem.

Rekomandimi 8

Të finalizojë ngritjen e Komitetit të Prodhuesve të Statistikave Zyrtare, i cili është një mekanizëm i rëndësishëm për cilësinë e proceseve të planifikimit dhe ndjekjes së aktiviteteve statistikore.

Statusi: Realizuar

Komiteti i Prodhuesve të Statistikave Zyrtare është ngritur me urdhërin e përbashkët të titullarëve të INSTAT-it, Bankës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 563 prot., datë 25.03.2020. Në muajin Dhjetor është zhvilluar mbledhja e parë e tij ku është diskutuar mbi punën përgatitore për projekt-Programin e ri të Statistikave Zyrtare.

Rekomandimi 9

Të punojë për t'iu përafruar gjithnjë e më tepër pritshmërive dhe kënaqësisë së përdoruesve të statistikave zyrtare, duke respektuar në mënyrë rigoroze parimet statistikore dhe standardet ndërkombëtare, nëpërmjet rritjes së edukimit statistikor dhe organizimit të takimeve formale e informale me përfaqësuesit e medias.

Statusi: Në proces

Për arsye të Covid-19 nuk ka qenë e mundur zhvillimi i takimeve me përfaqësuesit e grupeve të medias gjatë vitit 2020. Megjithatë, INSTAT ka arritur të përgatisë module informacioni "Statistika në Shkolla"

për rritjen e njohurive statistikore nga nxënësit e moshave të ndryshme dhe rritjen e ndërgjegjësimit mbi rëndësinë e statistikave në vend, duke i dedikuar një seksion të veçantë në faqen e web: http://instat.gov.al/al/statistikat-në-shkolla/